



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PERMET
SEKTORI I M.Z.SH-SE

Nr: 25 prot.

Përmet, me 16/09/2025

INFORMACION

LENDË: Dërgim Informacioni për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, për periudhën Janar-Shtator nga Sektori I M.Z.SH-se.

DREJTUAR: Kryetarit të Bashkisë

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2025, efektivit I M.Z.SH-se Permet, në zbatim të ligjit 152/2015, ka zbatuar urdhrat dhe udhëzimet të ardhura nga kryetari i bashkisë, Prefektura, Drejtoria e Përgjithëshme e M.Z.SH-se dhe M.B.

Në muajin qershor, periudhë e cila perkon edhe me shtimin e rrezikut për zjarre gjatë stinës së nxehtë të verës, është hartuar edhe plani i masave për përballimin e situatave gjatë kësaj stine, miratuar edhe nga Kryetari i bashkisë.

Gjatë kësaj periudhe efektivit I M.Z.SH-se Permet, ka treguar perkushtim, gadishmeri dhe devotshmeri, duke iu përgjigjur çdo rasti emergjent me efikasitet të plotë.

Mund të jemi nga të paktat stacione, duke marrë njoftime të shpejta dhe reagim të shpejtë njëkohsisht, kemi bërë e mundur që demet të jenë minimale në prona apo dëmtime në njerez.

Ne gjithë punën të përditshme, mund të quajmë operacione të mëdha dhe të sukseshme zjarrin në Landifillin e Piskovë në më shumë se 10 ditë, zjarrin në Kutal-Kosinë në vendgrumbullin e vjetër të plehrave shtatë ditë rresht me 100% të efektivitetit, zjarrin në ndihmë të Bashkisë Tepelene, Meemaliaj, etj dhe shpëtimi i turistave në Kanionin e Lengarices, shpëtimin e një shtetasi mbi Qafën e Manit, të cilin e kishte zënë mushka në një terren të vështirë.

Në punën të kemi marrë urime nga të gjitha strukturat që merren me perballimin e rasteve të emergjencës.

Nuk mund të leme pa përmendur edhe ndihmën e dhënë nga bashkitë fqinje, Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit dhe strukturave të bashkisë, Sherbimit Pyror pranë bashkisë dhe Zonat e Mbrotura.

Kemi pasur edhe vështirësi në raste të vecanta, si për furnizimin në zjarr të efektivave operacionale me pajisje të thjeshta, ujë, ushqim e veshje, kur kemi ghirë natën në zjarr.

Në përfundim, themi që puna e sektorit të ndërmarrë që na kanë mbështetur ka qenë e shkëlqyer, kjo falë edhe mbështetjes nga Kryetari i bashkisë dhe Shtabit të Emergjencave të ngritur për këtë qëllim.

Sipas statistikave të dërguara edhe në Ministri, po listojmë rastet e nderhyrjeve operacionale në bashkinë tënde për periudhën Janar_shtator 2025, si më poshtë:

- Zjarre në mbeturina, plehra, shkurre ,pyje, toke are etj.....	gjithsej	60
- Emergjencia të #, zhbllokim dëre, evakuim turistesh etj.....	gjithsej	17
- Zjarre në varreza, pemetore etj.....	gjithsej	5
	TOTAL	82

Shefi i Sektorit
K/ Inspektor Fredi LIPE

